



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

1. Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv , një (1) pozitë te karrierës:

Titulli: Një (1) Asistente Ekzekutive

Numri i referencës : ASK-ZKE-001

Koeficienti :7

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Siguron mbështetje administrative dhe teknike përfshirë , postën zyrtare , telefonatat skanimet , faksimi dhe kopjimi i dokumenteve si dhe hartimi i dokumenteve për takime të ndryshme,
- Komunikon direkt dhe ne emër te mbikëqyrësit ne njësit organizative te brendshme ,
- Përgatit dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën ,raportet , memorandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin,
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin,
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike te dokumenteve dhe dosjes të zyrës së mbikëqyrësit ,
- Menaxhon kalendarin e takimeve ,
- Ndhmon mbikëqyrësin në caktimin dhe koordinimin e takimeve të ndryshme dhe merrë pjesë në takime nëse është e nevojshme,
- Për punët dhe detyrat e kryera i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Kualifikimi arsimor: Shkollimi bachelor nga fushat ekonomike , shoqërore , juridike dhe administrative.

-Përvoja : Së paku 4 vite përvojë pune në fushën relevante

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohuri në të gjitha aspektet e ofrimit të shërbimeve dhe koordinimit si dhe aftësi në punët administrative –teknike,
- Aftësi pune me kompjuter (Word, Excel, Power Point, Access)
- Njohja e gjuhës angleze,
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të caktuara,
- Shkathtësi të mira të komunikimit,
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të personelit në nivelin administrativ dhe teknik.

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës , Rr,”Zenel Salihu” nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës , vertetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurrioni. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.